



**Hapet Thirrja për mobilitete (bursa) studentësh dhe stafi të UPT-së
në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus +
në Universidad Politécnica de Cartagena, Spanjë.**

Në kuadër të marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentë dhe staf të Universitetit Politeknik të Tiranës, në Universidad Politécnica de Cartagena - UPCT.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

Shkëmbimin e stafit për mësimdhënie dhe trajnim - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Drejtoritë në UPT.

Shkëmbimin e studentëve për studime - Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, (Studentë që gjatë vitit akademik 2023 – 2024 të jenë në vitin e dytë ose të tretë).

Numri total i stafit: 4 (2 për mësimdhënie dhe 2 për trajnim)

Numri total i studentëve: 2

Koha e kryerjes së mobilitetit: Semestri i parë i vitit akademik 2023

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës**;
- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching/Training) për stafin në universitetin pritës***.
- Motivation Letter;
- Work Plan;
- English or Spanish Language Competency (B2 or higher according to the CEFR)

**Plani i mobilitetit për, si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikanti bën pjesë.*

***Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve si staf në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/Titullar Departamenti ose program studimi/Profesor), për kryerjen e aktivitetit gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aproves, të cilin do të duhet ta bashkangjisni me dokumentet e tjera për aplikimin tuaj.*

**** Mobility Agreement for Teaching/Training për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*



Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve Bachelor deri në momentin e aplikimit (Academic transcript of records and achievement);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj* (English or Spanish Language Competency (B2 or higher according to the CEFR));
- Dokumenti Learning Agreement**.

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar për të dyja gjuhët është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në UPCT lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës. Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement” klikoni te:

[Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](https://www.upt.al/images/stories/projekte/ANEKS%2020-%20Mobility-agreement-studies.%20student.pdf) , aneks 2.
<https://www.upt.al/images/stories/projekte/ANEKS%2020-%20Mobility-agreement-studies.%20student.pdf>

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 5 maj 2023, ora 12.00.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al , abeqo@upt.al

Brenda muajit qershor 2023 kryhet seleksionimi final nga UPCT

Bashkëlidhur gjeni:

- [Erasmus+ Mobility Agreement Staff Mobility for Teaching](#)
- [Erasmus+ Mobility Agreement Staff Mobility for Training](#)



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

